

VENDIM
Nr. 153, datë 11.12.2015

**MBI OPERIMIN NË TREG TË PRODHUESVE ME KAPACITET TË INSTALUAR NËN
1 MW DHE VETËPRODHUESVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në bazë të neneve 16; 18; 20, germa “a”; 37, pika 6, germa “b”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 10, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.2008, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; nenit 23, pika 4, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendim nr. 21, datë 18.3.2009, i ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.12.2015, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike, në lidhje me operimin në treg të prodhuesve kapacitet të instaluar deri në 1 MW,

konstatoi se:

1. ERE merr vendime të cilat janë të detyrueshme për zbatim nga të gjithë të licencuarit që veprojnë në sektorin e energjisë elektrike (neni 20, germa “a”, i ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”).

2. ERE, ndër objektivat e saj, ka krijimin e kushteve lehtësuese për futjen në rrjet të kapaciteteve të reja prodhuese, si dhe heqjen e barrierave që mund të pengojnë futjen e pjesëmarrësve të rinj të tregut (neni 18, pika “b”, e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”).

3. Çdo shoqëri tregtare që dëshiron të ushtrojë aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike me kapacitet të instaluar deri në 1 MW, mund ta bëjë atë pa miratimin e ERE-s (neni 37, pika 6, germa “b”, i ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”).

4. Administrata publike, në ushtrimin e funksioneve të saj, mbron në çdo rast interesin publik, si dhe të drejtat dhe interesat kushtetuese e ligjore të personave privatë (neni 10 i ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”).

VENDOSI:

1. Vetëprodhuesit, të cilët nuk janë të lidhur me rrjetin kombëtar ose kur lidhen në rrjetin kombëtar për qëllime të mirëmbajtjes së njësisë së prodhimit, nuk pajisen me licencë nga ERE.

2. Prodhuesit, përfshirë dhe vetëprodhuesit e energjisë elektrike të lidhur në rrjetin kombëtar, me kapacitet të instaluar deri në 1 MW, nuk pajisen me licencë nga ERE.

3. Kategoritë e prodhuesve dhe të vetëprodhuesve të parashikuar në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi, kanë detyrimin të njoftojnë ERE-n, në çdo rast që fillojnë të ushtrojnë veprimtari në tregun e energjisë elektrike.

4. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të licencuarit KESH sh.a., OST sh.a. dhe OSHEE sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit Ahmeti